



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

ARJ nr.60/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË-kolegji i përberë nga gjyqtarët; Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike në konflikt administrativ sipas padisë së paditësit-propozuesit, “I., B.I”, me emër tregtar “RKDS-I”. , me seli në rr., në L., sipas autorizimit e përfaqëson avokat Fatos Zeqiri nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës(ATK), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, nr. prot. 543/2023 të dt. 30.12.2023, dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të parashtruar nga paditësi, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.708/24, të datës 25.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 25 Prill 2024, merr këtë;

A K T V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi-propozuesi, “I.R., B.I”, me emër tregtar “RKDS-I”, me seli në L., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, Kom. Dh. Sh. II. nr. 708/24, të datës 25.03.2024.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Dytë, **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e propozuesit-paditësit, “I.R B.I”, me seli në rr.”....”, L., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF Nr. ../., i datës 16.02.2024, **VËRTETOHET**.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Shk. së II-të, të Gjykatës Komerciale, propozuesi-paditësi, për mes përfaqësuesit avokat Fatos Zeqiri, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes së ligjit material, me propozim, të aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, i dhomave të shkallës së dytë, K.DH.SH.II., nr.708-24 i dt. 25.03.2024 dhe aktvendimi i dhomave të shkallës së parë, KF nr. 77/24, i dt. 16.02.2024, ashtu që të shtyhet ekzekutimi i Vendimit me numër nr.prot.543/2023, i datës 30.12.2023 i pranuar nga propozuesi me datë 09.01.2024, deri në vendosjen sipas padisë së propozuesit/paditësit ,ose me aprovimin e kërkesës së paditësit të ushtruar nga përfaqësuesi i tij të anulohen aktvendimet e kontestuara të Gjykatës Komerciale dhe lënda ti kthehet dhomave të shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të Dhomës së shkallës së dytë, dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të akteve të tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF Nr. 77/2023, të datës 16.02.2024, refuzohet si e pa bazuar propozimi-kërkesa e paditësit, "I.R B.I", me seli në L., me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit përfundimtar- vendimit, me numër protokolli 543/2023, të datës 30.12.2023 të Administrata Tatimore e Kosovës(ATK), me seli në P., deri në vendosjen sipas padisë së propozuesit/paditësit.

Dhoma e Shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 13, par.6, të Ligjit 08/L015, për Gjykatën Komerciale dhe 194, të LPK-së, (ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), e refuzon ankesën e paditësve si të pa bazuar ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërteton. Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, qëndrimin juridik të saj e pranon në tërësi së të drejtë dhe ligjor nga se edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nga paditësi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së, andaj nuk gjen prova se vendimi i shkallës së parë është i përfshire me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës apo me zbatim të gabuar të ligjit. Sipas vlerësimit të kolegjit të shkallës së dytë, shkalla e parë drejtë ka konstatuar rrethanat faktike me refuzimin e kërkesës së paditësit sepse i njëjti edhe me ankesë nuk arrinë ti mbështes me asnjë provë pretendimet dhe duke mos propozuar prova me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet, për dëmin konkret që mund ti shkaktohej dhe i cili vështirë do të riparohej me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur. Nga kjo gjendje e konstatuar vlerëson se paditësi në shkallën e parë por edhe në procedurë ankimore nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e tij që me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur do ti sillte dëm konkret dhe i matshëm, i cili vështirë do të riparohej, e po ashtu nuk e ka bërë të besueshme pretendimin se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare.

Me nenin 22 par.2 , të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, *me kërkesën e paditësit organi, akti i të cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22, paragrafi 6, të njëjtit ligj përcaktohet se, paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.*

Kolegji i Gjykatës Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit, aktvendimit të atakuar të Gjykatës Komerciale, të shkallës së dytë dhe atë të shkallës së

parë gjen se, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë si në aktvendimet e tyre të apeluara, bazuar në nenin 22 të LKA-së, të cituar si më lartë, me refuzimin e kërkesës-propozimit të paditësit nga dhoma e shkallës së parë dhe ankesës nga dhoma e shkallës së dytë si të pa bazuar, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, nr. prot. 543/2023 të dt. 30.12.2023 të ATK-së, deri në vendosjen meritorie të çështjes me vendim përfundimtar gjyqësor. Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së dytë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë sepse i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale si pretendon paditësi në kërkesë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi me kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ashtu si edhe në gjykatat e instancave më të ulëta, nuk arrin të argumentoj me prova konkrete dhe bindëse se me ekzekutimin e vendimit të atakuar të ATK, do të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do të shkaktohte dëm të madh palës kundërshtare-kundër propozuesit, përkatësisht palës së interesuar.

Pretendimet në kërkesë të paditësit si më lartë dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj se, tani biznesin e ka shitur me të gjitha asetet dhe obligimet dhe nuk mban përgjegjësi për te, se me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur i shkaktohet dëm me që çështja e tij nga shkalla e dytë administrative nuk është vendosur në mënyrë meritorie por është hedhë ankesa si jo e afatshme andaj gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht kanë trajtuar kushtet e parapara në nenin 22 të LKA me refuzimin e propozimit sepse paditësi nuk e ka humbur afatin e ushtrimit të ankesës dhe se kundër propozuesi është dashtë të vendosi në mënyrë meritorie e jo ta hedhë ankesën e tij, se gjykatat më të ulëta nuk e kanë trajtuar provat materiale, sepse shuma e cila i ngarkohet për pagesë 690,630.67€, në emër të TVSH, tatim në fitim dhe ndëshkime është shumë e lartë dhe me këtë i shkaktohet dëm i pa riparueshëm, për deri sa kundër propozuesi është duke ndërmarrë veprime për konfiskim të pronave dhe asetëve të propozuesit pa e trajtuar ankesën e tij meritorisht. Kolegji i Gjykatës Supreme pretendimet si më lartë, dhe të tjerat në kërkesë në këtë drejtim i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të argumentuara dhe bindëse për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe për tu aprovuar masa e përkohshme. Pretendimet në kërkesë kjo gjykatë i vlerëson të përgjithësuara pa mbështetje në prova dhe fakte konkrete që do ta bënin të besueshme kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, sepse nuk dëshmohet nga paditësit me fakte dhe prova materiale, se cili është dëmi konkret real dhe i matshëm që do të shkaktohej me ekzekutimin e vendimit të kontestuar, i cili vështirë do të riparohet, për tu përmbushur kushtet ligjore ashtu si parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së. Paditësi kryesisht kërkesën e tij e ndërlihd me vendosjen e çështjes kryesore sipas padisë, lidhur me kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur me të cilin i është hedhur ankesa si jo e afatshme, por në këtë drejtim kjo çështje shqyrtohet gjatë vendosjes meritorie ku vlerësohet ligjshmëria e vendimit të organit të paditur, andaj nuk është me ndikim për vendosje për masë të përkohshme sepse në këtë fazë vlerësohen vetëm plotësimi i kushteve si parashihet me nenin 22 të LKA-së. Kolegji vlerëson se pretendimet e njëjta janë paraqitur dhe shqyrtuar edhe në instancat më të ulëta dhe me të drejtë nuk janë pranuar se janë me ndikim për tu aprovuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur.

Nga theksimet si më lartë rezulton se aktvendimet e kontestuara të gjykatave të instancave më të ulëta janë të drejtë dhe ligjor, dhe të arsyetuar mjaftueshëm duke u paraqitur arsyet dhe faktet e nevojshme për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes së çështjes për masë të përkohshme, sipas provave në shkresa të lëndës, gjithnjë duke u kujdesur që mënyra e vendosjes për masë të përkohshme dhe arsyetimi i vendimmarrjes, mos të prejudioj mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, sipas gjendjes së fakteve të vërtetuara që kanë qenë me ndikim për refuzimin e ankesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur. Në këtë çështje edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Nga parashtrimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr. 60/2024, me datë 25 Prill 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani